



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 895/1 Prot.

Tiranë, më 10.06.2022

**V E N D I M**

**Nr. 110, Datë 10.06.2022**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 202, datë 05.11.2021, të A.K kundër Shoqërisë Bankers Petroleum Albania LTD (Bankers), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike<sup>1</sup>” dhe “bindjes fetare<sup>2</sup>”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>3</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe me e-mail-in datë 11.11.2021, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Kam filluar punë pranë Bankers Petroleum Albania me datë 03.01.2008, në pozicionin financiere (senior accountant) dhe kam punuar deri në datë 12.05.2021, kur më është komunikuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Në Qershor 2018, drejtuesi Kinez, X.S, erdhi me një platformë të re drejtimi dhe vendosi të bëjë disa ndryshime strukturore, si dhe lëvizje të stafit drejtues. Në fund të vitit 2019 dhe në fillim të vitit 2020, një pjesë e ish drejtuesve Kanadez dhe Shqiptarë, u konfliktuan me drejtuesin e kompanisë, X.S, e si pasojë ata u pushuan nga puna dhe u konfliktuan me kompaninë legalisht dhe mediatikisht. Në vijim po pasqyroj ecurinë e situatës që nga momenti kur u bëra subjekt i një auditimi të brendshëm të padrejtë dhe diskriminues që i ngjante më shumë një hetimi të autorizuar, e*

<sup>1</sup> Referuar shkresës nr. 38/1, datë 07.02.2022 të lëshuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim, vërtetohet se ankuesja është angazhuar gjatë fushatës elektorale në zgjedhjet e vitit 2021, pranë shtabit elektorale të LSI, dega Fier. Ankuesja deklaroi se ka qenë pjesë e spotit publicitar të LSI Fier, gjatë zgjedhjeve të vitit 2021.

<sup>2</sup> Ankuesja deklaroi se është e besimit fetar, ortodoks.

<sup>3</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

miratuar prej drejtuesve më të lartë të kompanisë dhe vënë në zbatim nga një ekip njerëzish pa eksperiencë në auditim si, I.J dhe V.M. Në këtë kuadër, eprorët Kinez çelën dhe një adresë e-maili ku u kërkonin kujdo që kishte informacion për raste korruptive të shkruante. Mbas kësaj, një grup njerëzish që kishin punuar apo bashkëpunuar me ish-drejtuesit, u thirrën për t'u intervistuar dhe për të dhënë shpjegime për rolin e tyre në këto bashkëpunime me ish-drejtuesit, nga I.J. Intevistën e parë me I.J e kam bërë në muajin Prill 2020, ku kam dhënë disa shpjegime për punën dhe detyrën time dhe për pyetjet që më bëri. Kjo intervistë ka qenë pa procesverbal. Me datë 02.11.2020, unë kërkohem sërish për t'u intervistuar nga I.J. Për këtë takim është mbajtur dhe një procesverbal. Me datë 06.11.2020 më dërgohet një email nga Burimet Njerëzore ku më komunikohet se për shkak të një investigimi që po zhvillohet nga Auditi i Brendshëm, kompania kishte vendosur të më pezullonte nga puna deri në përfundimin e auditimit. Me datë 18.11.2020 më komunikohet shkresa, njoftim për takimin që do të zhvillohet me datë 23.11.2020, në lidhje me shkëljet e konstatuara. Me datë 15.12.2020, më komunikohet dhënia e masës disiplinore, "Paralajmërim me shkrim" dhe revokim i pezullimit. Më detyrojnë ta firmos këtë shkresë, me pretekstin se është për procedurë dhe bëhet me qëllim që të mbyllet procesi i auditimit edhe pse nuk isha dakort, mu desh ta firmosja për tu kthyer në punë. Në muajin janar 2021, bëhet performanca e punonjësve dhe rishikimi i pagës. Shefja ime M.I më bën një performancë shumë të mirë. Në vijim, i dërgoj një email zyrtar shefit tim Kinez, Drejtor i Financës, ku i kërkoj rritje ose sistemim page. Më pas, në muajin mars 2021 i dërgoj një email tjetër drejtorit, ku i them se besoj se këtë muaj do të kemi rritje ose sistemim rroge. Drejtorin e Financës e largojnë nga pozicioni dhe emërohet një drejtor tjetër. Ndërkohë unë vazhdoja të punoja normalisht në pozicionin tim dhe duket sikur çdo gjë u mbyll. Me datë 29.04.2021, me komunikohet shkresa, "Njoftim për takim për diskutimin në lidhje me ecurinë e kontratës së punës". Në vijim, me datë 30.04.2021, i dërgoj një e-mail CEO-s së kompanisë, ku i paraqes shqetësimet dhe ankimet e mia. Nuk marr përgjigje. Në procesverbalin e takimit, datë 05.05.2021, nga ana ime u parashtrua se: - Kush është arsyeja që më ushtroni presion dhe më kërcënoni për muaj të tërë? - Ju po më thoni që ky është një shkurtim pozicioni? Pse mua? - Unë kam 13 vjet punë, më shumë se të gjithë në departament, kështu që kjo nuk bën sens. - Performanca ime ka qenë gjithmonë shumë e mirë. - Dhe më e rëndësishmja është që manaxherja ime M.I ka kërkuar staf të ri gjatë kësaj kohe, sepse kemi mungesë stafi. Me datë 06.05.2021, i dërgoj një email tjetër CEO-s së kompanisë, ku i shkruaj se: - Bazuar mbi çfarë kriteri keni vendosur ndërprerjen e kontratës së punës? - Ne jemi katër financierë në zyrë, në departamentin e Financës në Kompaninë Bankers. - Justifikimet tuaja për ndërprerjen e kontratës nuk bëjnë sens, nuk kanë llogjikë, duke ditur që ka një kërkesë nga shefja ime e cila kërkon dhe dy punonjës të tjerë ekstra, pasi stafi ekzistues nuk mund ta përballojë dot ngarkesën e punës. - Pra për mua ky vendim ka vetëm një emër, Diskriminim! Përsëri asnjë përgjigje. Me datë 10.05.2021, bëhet takimi i dytë për të diskutuar mbi vijimin e marrëdhënies time të punës me kompaninë, me synimin për të arritur një zgjidhje sa më të pranueshme për të dyja palët të situatës së shkaktuar nga pamundësia e rishikimit të ristrukturimit si dhe sistemimit në një pozicion të të njëjtit nivel dhe me të njëjtën pagë për punëmarrësin. Në datë 11.05.2021, dërgoj një email zyrtar zyrës së

*Burimeve Njerëzore, në të cilin refuzova ofertën e punëdhënësit dhe parashtrova se u bë një vit tashmë që unë kam qenë subjekt i fajësimeve, shantazhit, ngacmimeve dhe diskriminimit nga strukturat e krijuara nga ish-CEO, të cilat po mbahen dhe po mbështeten edhe nga ju. Përsëri asnjë përgjigje. Në datë 12.05.2021, më komunikohet vendimi mbi zgjidhjen e kontratës së punës, me arsyen e shkurtimit të pozicionit të punës për shkak të ndryshimit të dy strukturave organizative dhe rishikimit të detyrave në Departamentin e Financës. Me datë 01.06.2021, i dërgoj kompanisë Bankers, një kërkesë për punë, ku shpreh interesin tim për çdo pozicion pune të hapur në financë apo dhe ndonjë departament tjetër që ka lidhje me arsimimin dhe edukimin tim. Gjithashtu, me anë të një kërkesë drejtuar Burimeve Njerëzore datë 05.10.2021 (email), kam bërë sërish një përpjekje tjetër për tu punësuar pranë Bankers”.*

Ankuesja informon se pas largimit të saj, në zyrën e financës kanë filluar punë dy punonjëse të tjera.

Ankuesja pretendon se diskriminohet për arsye krahinore dhe fetare, pasi të gjithë ish shefat e Bankers si: L.Ç, D.Th, G.V, F.B, O.F, J.Dh, etj, ishin myzeqarë dhe ortodoksë, dhe ajo duke qenë myzeqare dhe ortodokse është “kategorizuar” me pa të drejtë në të njëjtin grupim me ish shefat, duke bërë asosacione të paqena. Ankuesja deklaroi se prej vitit 2019 ka qenë simpatizante dhe pjesëmarrëse në aktivitetet e subjektit politik LSI, dhe në datë 4 prill 2021 ka dalë spoti i LSI-së në media, ku ajo ka qenë pjesë e atij spoti publicitar. Ankuesja pretendon se bindjet e saja politike janë të kundërta me ato të I.J, Drejtuesja e Auditit të Brendshëm, e cila ka ndjekur procedurën e largimit të saj nga puna. Ankuesja informon se pas blerjes së kompanisë nga shtetasit e huaj, po rekrutohen pranë kompanisë vetëm punonjës që i përkasin bindjeve politike të partisë në pushtet, gjë që ka sjellë si pasojë trajtimin e saj në mënyrë të padrejtë, duke bërë të mundur largimin nga puna dhe duke i mohuar dhënien e aksesit në procedurat e konkurimit për vende të lira pune.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës<sup>4</sup>.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>5</sup>, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatëzinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet

<sup>4</sup> Referuar deklaratimit të ankueses, të bërë gjatë seancës dëgjimore, datë 03.02.2022.

<sup>5</sup> Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

*gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, garantohet *ndaj çdo veprimi apo mosveprim* të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët *publikë apo privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën nr. 1525/2, datë 15.11.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Bankers Petroleum, për ankesën e bërë nga A.K si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
  - Kopje të plotë të strukturës organizative dhe organikës së vjetër, të Shoqërisë Bankers Petroleum.
  - Kopje të plotë të strukturës organizative dhe organikës së ndryshuar, të Shoqërisë Bankers Petroleum.
  - Kopje të studimit të bërë mbi ristrukturimin e Shoqërisë Bankers Petroleum dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e punonjësve që do largoheshin apo ndryshonin pozicionin e punës për shkak të ristrukturimit.
  - Kopje të dosjes personale të ankueses. (vendim emërimi, kontrata pune, kopje të Librezës së Punës, masa disiplinore, vlerësim performance të tre viteve të fundit, nëse ka, etj).

- Kopje të plotë të procedurës së auditimit dhe të raportit të bërë nga grupi i auditimit. (Urdhrin e ngritjes së grupit të punës, detyrat, etj).
- Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e masës disiplinore për ankuesen.
- Informacion nëse janë dhënë masa disiplinore dhe për punonjës të tjerë, për shkeljen e detyrimeve kontraktore dhe politikave të zbatueshme në marrëdhëniet e punës. Nëse po, kopje të masave disiplinore.
- Kopje të plotë të procedurës së ndjekur lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen.
- Informacion nëse janë zgjidhur marrëdhëniet e punës dhe me punonjës të tjerë, për shkak të ristrukturimit. Nëse po, kopje të dokumentacionit.
- Kopje të kërkesave/ankesave të bëra nga A.K dhe përgjigjet e dhëna nga Bankers Petroleum.
- Kopje të kërkesave të bëra nga M.I për punonjës shtesë në zyrën e financës.
- Informacion nëse janë punësuar punonjës të tjerë në Departamentin e Financës dhe Departamentin e Prokurimeve, pas datës 12.05.2021, e në vijim.

Me shkresën nr. 945/1, datë 26.11.2021, Shoqëria Bankers Petroleum, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Bankers Petroleum Albania, për nevoja të aktivitetit në fushën e nxjerrjes dhe shitjes së naftës bruto, në zbatim të përcaktimeve ligjore, ka lidhur marrëdhënie pune me më shumë se 500 shtetas Shqiptarë, kryesisht banorë të zonës ku ushtron aktivitetin naftë-nxjerrës dhe rrethinave. Pretendimet e ankueses në lidhje me procedurat e auditimit të brendshëm që kanë sjellë masën disiplinore ndaj saj, apo ato për zgjidhjen e kontratës së punës si pasojë e ristrukturimit të Departamentit të Financës të Bankers si punëdhënës, janë krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra dhe as që kanë lidhje të ndonjë natyre, përveç llojit të marrëdhënies në të cilën janë dhënë. Siç rezulton nga përmbajtja e konkluzioneve të auditimit, që kanë përbërë shkakun për masën disiplinore, siç tregon qartë dhe motivimi i dhënë për atë, nga punëdhënësi është vlerësuar se A.K me veprimet për ofrimin e shërbimeve të specializuara për llogari të subjekteve të tretë që kishin marrëdhënie kontraktore me Bankers ka shkelur politikat e punëdhënësit për eliminimin e konfliktit të interesit dhe si pasojë ka cënuar detyrime të kontratës së punës të vlerësuara si të rëndësishme për Bankers. Si pasojë e gjetjeve nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Sektori i Marrëdhënieve me Komunitetin në periudhën 2019, 2020 janë ndërprerë marrëdhëniet e punës edhe për punonjës të tjerë të përfshirë në procedurat e financimit të projekteve për kontributin e Bankers në komunitetin e zonës, e madje për disa nga personat e përfshirë reagimi i punëdhënësit ka shkuar deri në kallëzimin për ndjekje penale të punëmarrësve, përgjegjës për shkelje të ligjit në dëm të Bankers. Ndërkohë siç dhe rezulton nga përmbajtja e dokumentave të procedurës për zgjidhjen e marrëdhënies së punës, ky veprim është motivuar nga shkaqe krejt të ndryshme nga sa më sipër, shkaqe që nuk kanë pasur të bëjnë me veprimet e ankueses, por me nevojën për të vënë në zbatim strukturën e re organizative të punëdhënësit, procedurë që është motivuar nga ana e saj, me uljen e kostove*

*për zhvillimin e operacioneve hidro-karbure. Marrëdhënia e punës me ankuesen për shkak të pozicionit të saj në strukturën pararendëse dhe nivelit të pagës që përfitonte është logjikuar si zgjidhja optimale ekonomike dhe prapa këtij vendimi nuk ka pasur asnjë motivim tjetër përveç optimizimit të veprimeve dhe politikës sociale, pasi është vlerësuar në kushtet e domosdoshmërisë që ishte më e logjikhme të ndërpritej marrëdhënia e punës me një person me pagë të lartë dhe volum pune jo shumë të rritur, se për më shumë se një person me pagë mesatare dhe volum të njëjtë pune. Për aplikimin e ristrukturimit nuk është kryer studim, por nga ana e autoritetit drejtues të Bankers si kritere në përzgjedhjen e pozicioneve që do prekeshin nga ristrukturimi janë vlerësuar ato sociale, të efikasitetit dhe optimizimit të ngarkesës së punës në raport me shpenzimet e pagave dhe menaxhimit të kostove të personelit. Vlen të theksojmë se ankueses pikërisht për pozicionin që kishte dhe kontributin e dhënë gjatë marrëdhënive të punës në kuadër të kësaj procedure i është ofruar një paketë kompensuese me vlerë të konsiderueshme, që në përmbajtje të saj kishte shpërblime që i kalonin disa herë kompensimet dhe pagesat e nevojshme në një procedur normale të marrëdhënive të punës. Fakti që ankuesja nuk e ka pranuar këtë paketë shton dyshimet që sjellja e saj në procedurën e zgjidhjes së marrëdhënive të punës ka qenë tendencioze e impostuar drejt synimit për të krijuar premisa konflikti. Në përmbushje të kërkesës, po paraqesim kopje të dokumentacionit të zgjidhjes së marrëdhënies së punës për punonjës të tjerë në të njëjtën periudhë dhe për të njëjtin shkak, dokumentacion që me përmbajtjen e tij do të provojë se procedura e ristrukturimit dhe efektet e saj janë ndjerë në pak a shumë të njëjtën masë në të gjithë sektorët. Kriteret themelore mbi të cilët aplikohen të gjitha fazat e marrëdhënies së punës në vijimësi nga Bankers kanë qenë, përshtatshmëria me pozicionin, efikasiteti në kryerjen e detyrave funksionale dhe respektimi i politikave dhe rregulloreve përkatëse gjatë marrëdhënies së punës. Ndryshe nga ankuesja nuk e quajmë me vend të përfshijmë persona konkretë në këtë arsyetim, por fakt i pamohueshëm është se edhe pse krejtësisht pa asnjë mbështetje faktike, vetë ankuesja nuk ka mundur të sjellë si shembuj më shumë se 3 raste rekrutimesh në një periudhë 3 vjeçare, në një kohë kur Bankers aplikon mesatarisht më shumë se 20 të tilla në vit. Në këtë kuadër, aludimet e ankueses për diskriminim krahinor ndaj saj, fetar apo politik nuk kanë asnjë mbështetje dhe janë krejtësisht abuzive pasi: Së pari, vendi i kryerjes së operacioneve hidro-karbure të shoqërisë është në krahinën e Myzeqesë dhe si pasojë e kësaj dhe faktit se është një detyrim në zbatim të Marrëveshjes hidro-karbure, pjesa dërrmuese e personelit të Bankers janë nga kjo krahinë. Së dyti, aludimet për motivim për shkaqe fetare apo politike në veprimet ndaj ankueses janë edhe më revoltuese, pasi në asnjë rast si për shkak të procedurave ashtu edhe për shkak të mënyrës se si është organizuar Bankers nuk është marrë ndonjëherë informacion e as ka të dhëna në lidhje me këto elementë të bindjeve personale të punëmarrësve. Gjithashtu, informohet se në Departamentin e Financës të Bankers në periudhën Maj-Nëntor 2021, nuk ka pasur asnjë rekrutim të ri”.*

Në përgjigje të shkresës së Bankers Petroleum, ankuesja me email-in datë 13.12.2021 informoi se: “Nga ana e kompanisë është parashtruar se jam larguar nga pozicioni i punës dhe nga detyra për shkak të ristrukturimit që ka bërë kompania, gjë e cila nuk rezulton aspak e vërtetë për sa

*kohë nuk është bërë largimi i asnjë punonjësi tjetër të kompanisë dhe nuk mund të themi se ristrukturimi prek vetëm mua, ankuesen A.K. Nga ana e Bankers Petroleum është përmendur fakti se nga ana e tyre, mua ankueses më është ofruar një paketë kompensuese në vlerë të konsiderueshme. Ajo që nuk shkon në këtë pretendim është fakti se nëse kjo kompani pretendon se largimi nga puna është bërë për shkak të ristrukturimit, dhe ky ristrukturim ka ardhur për arsye ekonomike të kompanisë, për shkak të pagesës së lartë, atëherë me të drejtë lind pyetje: Mbi çfarë detyrimi ju keni ofruar këtë paketë kompensuese në vlerë të konsiderueshme ndaj meje ankueses?! Nëse do të pranoni si të vërtetë pretendimin se Bankers Petroleum nuk ka informacion dhe nuk është marrë ndonjëherë me bindjet politike personale të punonjësve të saj, si është e mundur që krenjt “rastësisht” pjesa me e madhe e punonjësve të rekrutuar kanë bindje të njëjta me ato të partisë politike në pushtet”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës nr. 202, datë 05.11.2021, Komisioneri me shkresën nr. 180, datë 25.01.2022 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 03.02.2022, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe pretendimet e palëve në proces.

Seanca u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesja A.K dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit me autorizim nr. 092, datë 02.02.2022, të Bankers Petroleum, z. O.S.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në, si dhe deklaroi se: *“Pozicioni i saj i punës nuk është shkurtuar, por punën e bëjnë punonjës të rinj..... Nuk ka pasë pagën më të lartë, ka qenë në të njëjtin nivel me punonjësit e tjerë dhe mund të ketë pasur një diferencë prej 5.000-7.000 lekë, për shkak të vjetërsisë. .... Paga e saj është shpërndarë tek punonjësit e tjerë sepse nuk e mbanin volumin e punës dhe 3-4 punonjëse kanë marrë shtesë. .... Duke qenë se shkak i ristrukturimit paska qenë paga e saj, përse nuk është thirrur për të negociuar pagën në kuadër të ristrukturimit?”.*

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi i Bankers Petroleum dorëzoi shpjegimet me shkrim, datë 03.02.2022, si dhe deklaroi se: *“Brenda departamentit të saj ka pas riorganizim të strukturës organizative. Shkaqet lidhen me llogjikën ekonomike, meqënëse kishte pagën më të lartë..... Vitin e fundit ka pasur 6 largime nga puna për shkak të ristrukturimit..... Vlerësimi është bërë në bazë të kriterit ekonomik”.*

Gjatë seancës dëgjimore nga ana e Komisionerit u kërkua që Bankers të dërgonte informacion dhe dokumentacion lidhur me numrin e punonjësve të kompanisë para dhe pas ristrukturimit si dhe praktikën e ristrukturimit të departamentit të financës.

Në vijim të detyrave të lëna gjatë seancës dëgjimore, Bankers Petroleum me shkresën nr. 125, datë 15.02.2022, dërgoi dokumentacionin e kërkuar dhe informoi Komisionerin se: *“Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna në seancën dëgjimore, bashkëngjitur do gjeni dokumentacionin e mëposhtëm:*

- *Formularë E-Sig “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe të larguarve nga puna” për periudhën Qershor 2021-Shkurt 2022, deklaratat nga numri 527 në numrin 553 (gjithsej 27 deklarime).*

*Këto dokumenta paraqiten për të provuar numrin e punësimeve përgjatë periudhës nga zgjidhja e marrëdhënieve me A.K deri në ditën e sotme dhe për të provuar se nuk është punësuar ndërkohë asnjë person në pozicionin kontabiliste (llogaritare/accountant) që ajo mbante në momentin e zgjidhjes së marrëdhënies së punës.*

- *Formulari plotë i aplikimit për shpalljen e një pozicioni të ri të punës për rekrutim në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për pozicionin Specialist i Thesarit/Ekonomist Finance dhe Banka.*

*Ky dokument paraqitet në përmbushje të kërkesës së Komisionerit, për të provuar transparencën e procedurës së rekrutimit të aplikuar nga Bankers dhe kërkesat për vendet e punës të pretenduara nga ankuesja se kanë të bëjnë me pozicionin që ajo mbante si kontabiliste në Departamentin e Financës.*

- *Procedura të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës në Departamentin e Financës dhe Departamentin e Thesarit në periudhën Shtator 2021-Janar 2022 (2 akte dorëheqje dhe 1 miratim për njëren prej këtyre për punonjës në këto Departamente).*

*Këto dokumenta paraqiten për të mbështetur argumentat e Bankers se ndërkohë nga Departamenti i Financës janë larguar dhe punonjës të tjerë që nuk janë zëvendësuar deri më sot, e punësimet e reja në Departamentin e Thesarit janë në rolin bazë, Specialist Thesari dhe janë kryer pjesërisht për të zëvendësuar punonjës të larguar.*

- *Kopje e printuar e nenit 10<sup>6</sup> të “Marrëveshjes Hidro-Karbure për vendburimin e Patos-Marinzës”, datë 19.06.2004.*

---

<sup>6</sup> 10.1 *“Kontraktori do të zgjedhi ekipin drejtues të tij dhe punonjësit sipas zgjedhjes së tij, dhe do të përcaktojë kushtet e punësimit dhe numrin e punonjësve që do të përdoret për Operacionet Hidrokarbure. Sidoqoftë, Kontraktori dhe nën-kontraktorët e tij, do të punësojnë, në masën e mundur, Shqiptar të kualifikuar për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure, duke i dhënë prioritetet personelit të Albpetrolit, nëse aftësitë profesionale, njohja dhe ekspertiza e tyre*



*Ky dokument paraqitet për të mbështetur argumentimin e paraqitur nga Bankers që për nevoja të aktiviteteve, ka detyrim ligjor punësimin e stafit lokal”.*

- Me shkresën nr. 345/1, datë 27.04.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion shtesë nga, Bankers Petroleum, për pretendimet e ngritura nga ankuesja gjatë seancës dëgjimore, si dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituar:
  - Informacion sa ka qenë numri i përgjithshëm i punonjësve përpara ristrukturimit dhe sa është numri i punonjësve pas ristrukturimit të kompanisë. Kopje të stukturës së vjetër dhe të re, të shoqëruar me numrin e punonjësve.
  - Informacion lidhur me punonjësit që janë larguar për shkak të ristrukturimit (departamenti, pozicioni, vjetërsia në punë tek Bankers, mosha dhe paga) dhe shpjegime nëse kriteri ekonomik (paga e lartë) ka qenë shkaku i largimit nga puna për të gjithë këto punonjës.
  - Informacion për datën kur ka mbaruar procesi i ristrukturimit të kompanisë.
  - Kopje të përshkrimit të punës të të gjithë punonjësve të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit (Dept – Finance & Accounting), sipas strukturës së vjetër.
  - Kopje të përshkrimit të punës të të gjithë punonjësve të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit (Dept – Finance & Accounting), sipas strukturës së re.
  - Kopje të detajuar të listë pagesës së muajit Mars 2021 dhe Janar 2022 të të gjithë punonjësve të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit.
  - Shpjegime se kush i kryen detyrat që më përpara i kryente ankuesja dhe a i është shtuar paga punonjësve që kanë marrë detyrat e ankueses.
  - Informacion mbi vjetërsinë në punë tek Bankers, të të gjithë punonjësve të Departamentit të Financës dhe Kontabilitetit, sipas strukturës së muajit Janar 2022.

Me shkresën nr. 380/1, datë 04.05.2022, Shoqëria Bankers Petroleum, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Para fillimit të fazës së parë të ristrukturimit në muajin Mars 2021 numri i përgjithshëm i punonjësve të Bankers Petroleum ka qenë 496. Në përfundim të fazës së parë të ristrukturimit në muajin Shtator 2021, numri i përgjithshëm i punonjësve ishte 490. Gjatë fazës së parë të ristrukturimit, gjatë vitit 2021 janë zgjidhur marrëdhëniet e punës nëpërmjet procedurave për ndërprerje të njëanëshme të kontratës së punës me punonjësit e mëposhtëm:*

Data fillimit të punës	Data efektive e ndërprerjes së punës	Emër Mbiemër	Pozicioni dhe Departamenti
01.09.2011	11.01.2021	D.S	Inxhinier Mekanik
01.02.2021	01.06.2021	D.P	Menaxher Prokurimesh

*përputhet me kërkesat operacionale. Nga ana tjetër, Kontraktori do të jetë i lirë të punësojë profesionistë të huaj të tillë, siç do ta gjykojë ai të nevojshme”.*

11.04.2011	26.06.2021	Y.D	Mirëmbajtës të makinerive
03.01.2008	01.09.2021	A.K	Kontabilist firme
12.11.2019	01.02.2022	I.J	Jurist
03.01.2013	01.02.2022	V.M	Nëpunës

*Ju qartësojmë se për shkak të detyrimit për ruajtjen e të dhënave personale sensitive nuk mund të vëmë në dispozicion informacion për datëlindjet e as për pagën mujore të këtyre ish-punëmarrësve pasi e kemi praktikisht të pamundur të marrim pëlqimin e tyre për të shpërndarë këtë lloj informacioni. Gjithashtu ju konfirmojmë se për 3 nga ish-punëmarrësit më sipër, kriter ka qenë optimizimi financiar i kostove, ndërsa marrëdhëniet e punës janë zgjidhur për të gjithë punonjësit e Departamentit të Auditit të Brendshëm (i riemërtuar Qëndrueshmëria e Korporatës gjatë ristrukturimit), për shkak të shkrirjes së këtij departamenti.*

*Lidhur me kërkesën për informacion se kur ka përfunduar ristrukturimi i Bankers Petroleum, bëjmë me dije se ky ristrukturim është zbatuar në disa faza dhe vazhdon ende, siç mund të vëreni nga përmbajtja e deklarimeve për numrin e punonjësve të subjektit, me orientimin drejt punësimeve të specialistëve të prodhimit, që kanë përbërë dhe numrin dërrmues të rekrutimeve të reja në periudhën Nëntor 2021, e në vijim.*

*Lidhur me kërkesën për informacion për punonjësit e departamentit të Financës që aktualisht kryejnë detyrat për të cilat më parë ishte përgjegjëse ankuesja, ju sqarojmë se këto detyra për shkak të mënyrës së organizimit të punës në Departament janë shpërndarë ndërmjet 2 kontabilistëve (accountant) dhe Zv/Menaxheres së Sektorit të Financës, që vazhdojnë të jenë në detyrë.*

*Gjithashtu bëjmë me dije se paga bazë e punonjësve që aktualisht kryejnë detyrat që më parë ishin në përshkrimin e punës të ankueses nuk është rritur si pasojë e shtimit të kësaj ngarkese pune por ka ndryshuar si pasojë e dhënies së një shpërblimi të veçantë, të lidhur me përshtatjen e mënyrës së organizimit të punës sipas procedurave të fiskalizimit dhe ndryshimet eventuale të pozicionit të punës. Për këtë arsye, bashkëngjitur do gjeni komunikimet formale të punëdhënësit për dhënie të shpërblimit të posaçëm për fiskalizimin”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.**

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën

*ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të pa drejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacionin në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Në Kreun II, të këtij ligji, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e punësimit. Ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, në nenin 12/1/c, ku përcaktohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ... c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.”*, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, bazuar në bindjen politike dhe fetare, që i bëhet një punëmarrësi në gëzimin e të drejtës për punësim.

*Referuar dokumentacionit të administruar gjatë procesit të hetimit, rezulton se:*

*“Bankers Petroleum Albania LTD”* është degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri, dhe ushtron aktivitetin e saj industrial në fushën e nxjerrjes dhe të prodhimit të naftës. Që prej vitit 2004 Bankers ka operuar dhe ka të drejta të plota të punës në fushat e Patos-Marinzës, në bazë të një Licence Marrëveshje të firmosur me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore për 25 vite dhe një Marrëveshje Hidrokarbure të firmosur me Albpetrol sh.a, për të njëjtën periudhë.

Referuar Librezës së Punës së A.K, rezulton se ka filluar punë si ekonomiste pranë Bankers, në datë 01.01.2008. Në datë 03.01.2008, mes palëve është lidhur Kontrata Individuale e Punës, në të

cilën rezulton se ankuesja ka filluar punë në pozicionin si financiere e re (junior accountant) dhe në datë 01.07.2014 në pozicionin si financiere. Në datë 01.03.2019, mes palëve është bërë një amendim i kontratës së punës, në të cilën ankuesja ka ndryshuar pozicionin e punës dhe pagën, duke u bërë, financiere e lartë (senior accountant).

Bazuar në informacionin dhe provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se, me shkresën nr. 1016/6, datë 15.12.2020, Bankers ka vendosur dhënien e masës disiplinore *“Paralajmërim me shkrim”*, për A.K, për *“Shkelje e detyrimeve kontraktore dhe politikave të zbatueshme në marrëdhënien e punës, duke mospërmbushur detyrimin e parashikuar në nenin 4 të Kodit të Sjelljes nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë profesionale në kushtet e konfliktit të interesit me kryerjen e punës për një nga kontraktorët e punëdhënësit gjatë periudhës së marrëdhënies së punës”*.

Me shkresën nr. 400/3, datë 12.05.2021, Bankers Petroleum ka vendosur për zgjidhjen e kontratës së punës të A.K, për arsye: *“Shkurtim i pozicionit të punës për shkak të ndryshimit të strukturave organizative dhe rishikimit të detyrave në Departamentin e Financës të punëdhënësit”*.

Ankuesja e kundërshton tek Komisioneri arsyen e largimit nga puna dhe pretendon se zgjidhja e kontratës së punës është bërë për shkak të bindjes politike dhe fetare, pasi ajo është anëtare e LSI-së dhe i përket besimit fetar, ortodoks.

- *Lidhur me masën disiplinore “Paralajmërim me shkrim” të marrë ndaj ankuseses me datë 15.12.2020.*

Në nenin 4 të Kodit të Sjelljes të Shoqërisë Bankers është përcaktuar se: *“Konflikti i interesit. Punonjësit nuk duhet të përfshihen ose të japin pamjen e përfshirjes në ndonjë aktivitet që përfshin një konflikt interesi, ose konflikt të mundshëm interesi, ndërmjet interesave personale dhe atyre të kompanisë. Çdo punësim i jashtëm ose përfshirje e jashtme në biznes nga një punonjës i kompanisë duhet t’i bëhet e ditur nga punonjësi, mbikëqyrësit të tij ose të saj”*.

Rezulton se masat disiplinore janë të parashikuara në nenin 19 të kontratës individuale të punës të nënshkruar nga palët. Në nenin 19.3 parashikohet se: *“Masat disiplinore renditen si më poshtë: I) “Paralajmërim me gojë”. II) “Paralajmërim me shkrim”. III) “Pezullim nga detyra pa të drejtë page për një periudhë jo më të gjatë se 5 ditë pune”. IV) “Zbritje në detyrë”. V) “Ndërprerje e kontratës së punës me efekt të menjëhershëm”*.

Me shkresën nr. 1016, datë 05.11.2020, Bankers ka njoftuar A.K për pezullimin e përkohshëm të marrëdhënies së punës, duke qenë se ndaj saj, në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së kryerjes së punës së saj, po zhvillohen veprime hetimore të brendshme.

Me shkresat nr. 1016/1, datë 18.11.2020 dhe nr. 1016/3, datë 26.11.2020, ankuesja është njoftuar për të zhvilluar takime në datë 23.11.2020 dhe 27.11.2020, për të biseduar rreth shkeljeve të konstatuara nga punëdhënësi dhe për të dëgjuar qëndrimin e ankuseses.

Referuar procesverbalit të takimit nr. 2, datë 02.12.2020 dhe nr. 3, datë 04.12.2020, Bankers ka informuar ankuesen me arsyen e takimit dhe provat ku bazohet shkelja<sup>7</sup> e konstatuar.

Ankuesja me deklaratën datë 02.12.2020 ka kërkuar kopje të provave dhe kohë për ti shqyrtuar dhe për të kthyer përgjigje me shkrim. Në mes të tjerash në këtë shkresë ankuesja ka deklaruar se: *“... Unë nuk jam e as nuk ndihem pjesë e asnjë grupimi, klani apo kategorie që po mundohen të më fusin me zor, për tu dukur apo për të justifikuar vendin e tyre të punës. ..”*.

Me përgjigjen me shkrim datë 04.12.2020, ankuesja ka dhënë opinionin e saj lidhur me gjetjet e raportit të auditimit dhe në mes të tjerash ka deklaruar se: *“Unë nuk i di arsyet e kësaj qasje por unë dhe kolegë të tjerë të përfshirë në këtë përpjekje e dimë që kemi punuar me etikë, profesionalizëm dhe duke respektuar kompaninë e ligjin. Çdo përpjekje për ta keqinterpretuar këtë punë si praktikë korruptive dhe ilegale është akt i papërgjegjshëm individual që besoj nuk do gëzojë mbështetjen e bordit të ri të drejtorëve”*.

Me shkresën nr. 1016/6, datë 15.12.2020, Bankers ka njoftuar ankuesen se në bazë të nenit 37 të Kodit të Punës punëdhënësi ka vendosur ti japë si masë disiplinore *“Paralajmërim me shkrim”*, i shënuar në regjistrat e personelit, për një periudhë 6 mujore, për: *“Shkelje e detyrimeve kontraktore dhe politikave të zbatueshme në marrëdhënien e punës, duke mospërbushur detyrimin e parashikuar në nenin 4 të Kodit të Sjelljes nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë profesionale në kushtet e konfliktit të interesit me kryerjen e punës për një nga kontraktorët e punëdhënësit gjatë periudhës së marrëdhënies së punës”*, dhe për heqjen e pezullimit nga detyra dhe për vijimin e përbushjes së detyrimeve nga data 15.12.2020.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara, Komisioneri vlerëson se, ankuesja nuk ka arritur të justifikojë veprimet e saja përpara Auditit të Brendshëm dhe drejtuesve të Bankers, lidhur me përfshirjen e saj në procedurat e financimit të projekteve të bëra nga Sektori i Marrëdhënieve me Komunitetin të Bankers Petroleum. Justifikimi i saj, nuk është i mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar, por ngelet në kuadër të deklarimeve dhe të pambështetura në prova.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga Bankers, rezulton se nga ana e kësaj kompanie është marrë masa disiplinore e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, dhe për një punonjës të Departamentit të Mbështetjes Teknike, për arsye të: *“Shkelje e rëndë e detyrimeve kontraktore në marrëdhëniet e punës, duke mos respektuar rregullat dhe politikat e kompanisë”*.

Gjithashtu, referuar informacioneve të publikuara në media<sup>8</sup>, rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, ishte duke zhvilluar veprime hetimore për dy punonjës të Bankers të cilët dyshoheshin se kishin abuzuar me fondet e kompanisë Bankers.

---

<sup>7</sup> *“Nga ana e A.K, janë kryer veprime që bien në kundërshtim me kontratën e punës të lidhur, po edhe me Kodin Penal, konkretisht nga ana juaj janë kryer veprime që kanë ndihmuar ish punëmarrësin A.G të kryej veprën penale të vjedhjes. Shkelje këto që do të kallëzohen edhe pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier”*.

<sup>8</sup> <https://telegraf.al/ekonomi/ja-si-abuzoi-me-faturo-fiktive-ish-kreu-i-bankers-l-c-qe-siguroi-104-milione-euro-per-3-vjet/>

Lidhur me informacionin e mësipërm, Komisioneri vlerëson se këto raste nuk mund të merren si situata për tu krahasuar me ankuesen, për arsye se nuk janë në kushte të njëjta apo të ngjashme, pasi në rastin e parë kemi masën disiplinore të largimit nga puna dhe në rastin e dytë kemi denoncim në organet ligjzbatuese për shkelje të ligjit.

Marrëdhëniet e punës së ankueses dhe Bankers janë rregulluara nga dispozitat e Kodit të Punës dhe kontratës së punës.

Në nenin 37 të Kodit të Punës, parashikohet se: *“Masat disiplinore parashikohen kryesisht në kontratën kolektive të punës. Në çdo rast kontrata individuale duhet t’i referohet akteve përkatëse, lidhur me masat disiplinore. Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova, brenda një afati të arsyeshëm”*.

Në nenin 19.5 të kontratës së punës është parashikuar se: *“Punëmarrësi ka të drejtë të ankimojë të Punëdhënësi masën disiplinore brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja dijeni për të. Procedura e shqyrtimit dhe përcaktimit të masës disiplinore nga punëdhënësi bëhet brenda një afati të arsyeshëm dhe garanton të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova”*.

Në shqyrtim të parashikimeve të legjislacionit të mësipërm, vlerësohet se Bankers në cilësinë e punëdhënësit ka respektuar procedurën për dhënie e masës disiplinore dhe i ka garantuar ankueses të drejtën për të përgatitur mbrojtjen dhe për të paraqitur shpjegimet e saj, lidhur me shkeljen e pretenduar nga punëdhënësi.

Referuar dokumentacionit të administruar, rezulton se A.K, ka firmosur shkresën për marrjen e njoftimit të masës disiplinore, por nuk ka ndërmarrë veprime për ta kundërshtuar atë tek punëdhënësi apo në gjykatë.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se procedura e ndjekur dhe vendimmarrja nga Bankers, rezulton e marrë në përfundim të një procesi të rregullt ligjor.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se për sa i përket dhënies së masës disiplinore *“Paralajmërim me shkrim”*, A.K nuk është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e punëdhënësit.

- *Lidhur me procesin e ndryshimit të strukturës organizative të shoqërisë Bankers Petroleum.*

Me Vendimin nr. 02, datë 20.04.2021, Bankers Petroleum vendosi miratimin e strukturës së re organizative dhe zbatimin e saj, duke filluar nga data 22.04.2021.

Referuar informacionit të dhënë nga Bankers Petroleum, rezulton se shoqëria përpara fillimit të ristrukturimit ka pasur 496 punonjës dhe në përfundim të fazës së parë të ristrukturimit, numri i

përgjithshëm i punonjësve ishte 490, pra 6 punonjës më pak. Referuar tabelës<sup>9</sup> me të dhënat e punonjësve që janë larguar për shkak të ristrukturimit, rezulton se informacioni i dërguar nga Bankers nuk është i saktë, pasi deri në muajin shtator 2021 janë larguar nga puna si rezultat i strukturës së re, 4 punonjës, ndërsa 2 punonjës të tjerë janë larguar në datë 01.02.2022, dmth pas përfundimit të fazës së parë të ristrukturimit të deklaruar nga Bankers.

Referuar vjetërsisë në punë të këtyre 6 punonjësve, rezulton se 2 punonjës kanë rreth 10 vjet vjetërsi në punë, 1 punonjës ka rreth 9 vjet vjetërsi në punë, 1 punonjës ka rreth 3 vjet vjetërsi në punë, 1 punonjës ka rreth 4 muaj vjetërsi, ndërsa ankuesja ka 13 vjet vjetërsi në punë.

Në analizë të këtij treguesi, vërehet se nuk ka një ndërlidhje mes kriterit të vjetërsisë në punë dhe punonjësve që u larguan gjatë procesit të ristrukturimit, pasi vjetërsia në punë e punonjësve të sipërcituar varion nga 4 muaj në 13 vite, ndërkohë që nuk ka të dhëna për të bërë të mundur vlerësimin e shpjegimit të dhënë nga Bankers se: *“..për 3 nga ish-punëmarrësit e larguar, kriter ka qenë optimizimi financiar i kostove”*.

Referuar strukturës së mëparshme (prill 2021) të Departamentit të Financës&Kontabilitetit, rezulton se departamenti ishte i përbërë nga 3 sektorë: Spektori i Financës, i cili përbëhej nga 1 menaxher dhe 6 punonjës; Spektori i Thesarit, i cili përbëhej nga 1 zv/menaxher dhe 1 punonjës; Spektori Financiar&Raportimit të Taksave, i cili përbëhej nga 1 zv/menaxher; pra në këtë departament ishin të punësuar gjithsej 12 persona: 10 punonjës, 1 zv/drejtor i përgjithshëm dhe 1 këshilltar financiar.

Me ndryshimin e strukturës (shtator 2021) të Departamentit të Financës&Kontabilitetit, rezulton se departamenti u riorganizua në 2 sektorë: Spektori i Financës, i cili përbëhej nga 1 menaxher dhe 5 punonjës; Spektori i Thesarit, i cili përbëhej nga 1 menaxher dhe 4 punonjës; pra në këtë departament ishin të punësuar gjithsej 14 persona: 11 punonjës, 1 zv/drejtor i përgjithshëm, 1 këshilltar financiar dhe 1 kontrollor financiar.

Në analizë të ndryshimit të strukturave të departamentit, rezulton se ky departament ka pasur riorganizim të sektorëve dhe ndryshime të emërimeve të punonjësve, por në total numri i punonjësve të Departamentit të Financës&Kontabilitetit, është shtuar me 2 punonjës.

Referuar ndryshimeve në strukturë, rezulton se Spektori i Financës dhe Raportimit të Brendshëm (Accounting Manager, Internal Reporting), në të cilën punonte ankuesja, ishte i përbërë nga 7 punonjës: “1 menaxher finance, 3 financierë, 1 asistent zyre, 1 asistent finance dhe ankuesja financiere e lartë” dhe do të ndryshonte dhe do të kishte në përbërje 6 punonjës: “1 menaxher finance, 1 zëvendës menaxher finance, 1 raportues financiar&taksa, 2 financierë dhe 1 asistent zyre”, pra është shkurtuar pozicioni i financieres së lartë dhe janë riemëruar disa pozicione pune, por nuk janë ndryshuar përshkrimet e punës së punonjësve.

---

<sup>9</sup> Shkresa nr. 380, datë 04.05.2022.

Referuar strukturës së re, rezulton se kishte ndryshime dhe në Sektorin e Thesarit dhe Sektorin Financiar&Raportimit të Taksave, të cilët përbëheshin nga 2+1 punonjës: (1 zëvendës menaxher i thesarit, 1 asistent thesari dhe 1 zëvendës menaxher financiar&raportimit të taksave) dhe me strukturën e re u ndryshua në Sektorin e Thesarit, i cili përbëhej nga 5 punonjës: (1 menaxher thesari dhe 4 specialistë thesari).

Në analizë të ndryshimeve në strukturë dhe organizim në Departamentin e Financës & Kontabilitetit, rezulton se në Sektorin e Financës është shkurtuar pozicioni i punës i ankueses (financiere e lartë) dhe në Sektorin e Thesarit janë shtuar 2 pozicione si specialist thesari.

Në analizë të riorganizimit të Sektorit të Financës, rezulton se pozicioni që mbante ankuesja si financiere e lartë është riorganizuar dhe nuk ekziston më në strukturën e re, ndërsa janë ndryshuar pozicionet e 3 punonjësve (1 punonjës nga asistent finance ka kaluar në financier, 1 financier ka kaluar në një pozicion të ri, si financiere&rapotuese e taksave dhe 1 financier ka kaluar në zv/menaxhere e financës).

Bankers Petroleum në informacionin e dërguar me shkresat nr. 945/1, datë 26.11.2021 dhe nr. 380/1, datë 04.05.2022, por dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, ka deklaruar se kriteri në përzgjedhjen e pozicioneve që do prekeshin nga ristrukturimi janë vlerësuar ato të efijensës dhe optimizimit të ngarkesës së punës në raport me shpenzimet e pagave dhe menaxhimit të kostove të personelit.

Referuar dokumentacionit të dërguar nga Bankers<sup>10</sup>, rezulton se në Departamentin e Financës & Kontabilitetit me strukturën e vjetër të muajit mars 2021, shpenzimi për pagën bazë mujore të këtij departamenti ka qenë: 1.512.018 lekë, ndërsa me strukturën e re pas riorganizimit është bërë: 1.698.700 lekë<sup>11</sup>, me një diferencë në rritje prej 186.682 lekë. Në analizë të këtij treguesi rezulton se është rritur paga për 4 punonjës, është shtuar numri i personelit me 2 punonjës të rinj dhe si rezultat me strukturën e re është rritur kosto e pagës bazë mujore e departamentit.

Referuar listës së pagave të Sektorit të Financës me strukturën e vjetër të muajit mars 2021, shpenzimi për pagën bazë mujore të këtij sektori ka qenë: 968.870 lekë, ndërsa me strukturën e re pas riorganizimit është bërë: 874.300 lekë<sup>12</sup>, me një diferencë në zbritje prej 94.570 lekë. Nga verifikimi i listë pagesës së muajit mars 2021, rezulton se ankuesja ka pasur pagën më të lartë prej rreth 20.000 lekë më shumë, krahasuar me financieren që kishte pagën më të lartë në këtë sektor.

Në analizë të këtij treguesi rezulton se në këtë sektor është rritur paga për 3 punonjës në pozicionet: zv/menaxhere e financës, financiere&rapotuese e taksave dhe financier. Në analizë të këtij treguesi rezulton se pavarësisht se është rritur paga për 3 punonjës, në total kostoja e pagës bazë të sektorit të financës është ulur.

<sup>10</sup> Referuar listës së pagave të muajit mars 2021 dhe janar 2022.

<sup>11</sup> Për efekt të llogaritjes se pagës bazë mujore të plotë për të gjithë punonjësit është llogaritur 22 ditë pune.

<sup>12</sup> Për efekt të llogaritjes se plotë të shumës së pagës bazë mujore, paga e pozicionit të financierit është llogaritur paga e muajit mars 2021.



Referuar treguesit të vjetërsisë në punë për pozicionet e financierit dhe të ankueses si financiere e lartë, rezulton se: ankuesja ka filluar punë në vitin 2008, dhe 3 financierët e tjerë kanë filluar punë, respektivisht në vitin 2011, 2014 dhe 2018, pra rezulton se ankuesja ka qenë punonjësja më e vjetër në sektor, krahasuar me financierët e tjerë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se Bankers Petroleum në datë 25.05.2021, ka shpërblyer me bonus financiar tre punonjëse,<sup>13</sup> në masën 162.810 lekë, për zbatimin e sistemit të ri fiskal.

Në përfundim të analizës, sa më sipër, rezultoi se Sektori i Financës, ka pësuar ndryshime në uljen e kostos së pagës dhe numrit të punonjësve, si rezultat i zbatimit të strukturës së re, por gjithashtu rezulton se në tërësi në Departamentin e Financës&Kontabilitetit, është shtuar numri i punonjësve dhe është rritur kostoja e pagës bazë mujore dhe shoqëria ka dhënë dhe bonuse për punonjësit, gjë që tregon se Shoqëria Bankers Petroleum nuk ka qenë në vështirësi financiare.

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se Shoqëria Bankers Petroleum, ka pasur një rritje të lehtë të kostos së pagave të personelit të Departamentit të Financës&Kontabilitetit, njëkohësisht dhe rritje të numrit të punonjësve në këtë departament, por Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk mund të vlerësojë dhe nuk ka tagër të gjykojë mbi mënyrën e zbatimit të politikave të eficientës dhe optimizimit të ngarkesës në punë apo nevojat e ritrukturimit, që Shoqëria Bankers Petroleum gjykon të nevojshme për menaxhimin e kostove dhe të personelit.

Komisioneri vlerëson se, mbështetur në atributet që i jep ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, mund të shqyrtojë kriteret në bazë të të cilave janë përzgjedhur punonjësit e prekur nga ristrukturimi, por në rastin konkret suprimimi i pozicionit të punës së ankueses, nuk lejon një shqyrtim të tillë.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, arsyeja dhe procedura e deklaruar nga Bankers për ndryshimin e strukturës dhe riorganizimit të shoqërisë, rezultoi e provuar. Në këto kushte provohet se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme nga ana e punëdhënësit, në kuptim të nenit 7, pika 1 të ligjit 10221/2010, i ndryshuar.

- *Lidhur me zbatimin e procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen.*

Referuar marrëdhënieve të punësimit, vlerësohet se secila nga palët ka të drejtën që të zgjidhë kontratën e punës në mënyrë të njëanshme. Kodi i Punës parashikon rregullat, procedurat dhe afatet që duhet të respektohen nga palët të cilat kanë hyrë në një marrëdhënie juridike punësimi dhe kanë lidhur midis tyre kontratën individuale të punës. Kodi i Punës parashikon dy mënyra të zgjidhjes së kontratës së punës, zgjidhjen normale dhe zgjidhjen e menjëhershme. Në të dyja rastet palët kanë detyrimin që të respektojnë procedurën dhe afatet e përcaktuara.

---

<sup>13</sup> Menaxheren e financës, zv/menaxheren e financës dhe financiere&rapotuese e taksave.

Përsa më sipër, nga ana e Bankers, filloi procedura për zbatimin e strukturës së re organizative dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës me subjektin ankues. Kështu, me shkresën nr. 400, datë 29.04.2021, A.K është njoftuar për takim për diskutim në lidhje me ecurinë e kontratës së punës.

Referuar procesverbalit nr. 400/1, datë 05.05.2021, të mbajtur mes palëve, Bankers ka informuar ankuesen se: *“Në kuadër të kërkesave operacionale, aktiviteteve të planifikuara të biznesit për këtë vit, Bankers ka kryer një riorganizim të strukturës organizative dhe rishikim të detyrave në disa departamente të saj. Si rrjedhojë e këtij riorganizimi shoqëria ka vendosur shkurtimin e pozicionit tuaj të punës”*.

Gjatë këtij takimi ankuesja ka deklaruar se: *“Ju po më thoni që ky është një shkurtim pozicioni? Pse mua? Unë kam 13 vite punë, më shumë se të gjithë në departament, kështu që kjo nuk ka kuptim. Performanca ime ka qenë gjithmonë shumë e mirë dhe më e rëndësishmja është se menaxherja ime ka kërkuar staf të ri sepse kemi mungesë stafi. Ju mund të zgjidhni të punoni dhe të besoni kë të doni, por pse nuk shikoni mundësinë për të më pozicionuar në departamentin e prokurimeve. Nëse nuk pranoni atëherë unë dua një paketë prej 50 pagash bruto”*.

Me e-mail-in datë 06.05.2021 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Bankers, ankuesja në mes të tjerash ka deklaruar se vendimi i largimit të saj nga puna është diskriminues.

Në datë 10.05.2021, mes palëve u mbajt takimi i dytë për ti komunikuar ankueses përgjigjen për kërkesat e bëra në takimin e parë. Referuar procesverbalit të takimit nr. 400/2, datë 10.05.2021, përfaqësuesit e Bankers kanë deklaruar se: *“Me synimin për të arritur një zgjidhje sa më të pranueshme për të dy palët të situatës së shkaktuar nga pamundësia e rishikimit të ristrukturimit, si dhe e sistemimit në një pozicion të të njëjtit nivel me të njëjtën pagë për punëmarrësin, Bankers i ofron punëmarrësit një paketë kompesuese të përbërë në total nga 24 paga mujore”*.

Në vijim të takimit dhe ofertës së bërë nga Bankers, ankuesja me e-mail-in datë 11.05.2021 është përgjigjur se refuzon ofertën dhe se nëse nuk plotësohen kërkesat e saj, do ti drejtohet gjykatës.

Me shkresën nr. 400/3, datë 12.05.2021, Bankers ka njoftuar ankuesen për zgjidhjen e kontratës së punës për arsye të: *“Shkurtim i pozicionit tuaj të punës për shkak të ndryshimit të strukturave organizative dhe rishikimit të detyrave në Departamentin e Financës të punëdhënësit”* dhe zgjidhja e kontratës së punës do bëhet pas përfundimit të afatit të njoftimit, në datë 31.08.2021, si dhe i ka ofruar shumat monetare sipas parashikimeve të nenit 94 dhe 145 të Kodit të Punës.

Referuar dokumentacionit të shqyrtuar, por dhe deklaratës<sup>14</sup> së ankueses të bërë gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, A.K nuk e ka ankimuar në gjykatë vendimin e largimit nga puna.

Referuar procesverbalit të takimit nr. 400/2, datë 10.05.2021, përfaqësuesit e Bankers e kanë vënë në dijeni ankuesen lidhur me pamundësinë e rishikimit të ristrukturimit, si dhe sistemimit të saj në

---

<sup>14</sup> Referuar seancës dëgjimore, min 07.45: “Procedurat e largimit nga puna kanë qenë të rregullta”.

një pozicion të të njëjtit nivel me të njëjtën pagë, pasi nuk kishte pozicione pune të së njëjtës pagë dhe të njëjtit nivel kualifikimi.

Referuar formularit të kërkesës për staf shtesë të plotësuar nga drejtuesit e Departamentit të Thesarit në datat: 21.06.2021 (kërkohen 2 punonjës) dhe 11.08.2021, janë bërë kërkesa që të punësohen punonjës në pozicionin si, specialist thesari për arsye të projektit të fiskalizimit dhe shtimit të punës në hedhjen e të dhënave dhe se marrja në punë e një punonjësi të ri, do lejojë punonjësit e kualifikuar dhe menaxherët që të delegojnë punët rutinë.

Në analizë për sa më sipër, rezulton se kërkesat e bëra nga Departamenti i Financës& Kontabilitetit për punonjës shtesë, kanë të bëjnë me kërkesa për pozicionin e punës si specialistë të rinj, për të kryer detyra të funksionit bazë për një ekonomist, ndërkohë që ankuesja ishte financiere e lartë dhe shumë e kualifikuar për pozicionin e punës të specialistit.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga Bankers, rezulton se shoqëria me shkresat nr. 868/2 dhe 944/2, datë 23.11.2021 ka vendosur zgjidhjen e kontratës së punës dhe me dy punonjës, për arsye se: *“Shkurtim i pozicionit të punës për shkak të ndryshimit të strukturës organizative dhe rishikimit të detyrave funksionale të nevojshme për punëdhënësin”*. Pra rezulton se Bankers ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe në rastin e punonjësve të tjerë të cilëve i ishte shkurtuar pozicioni i punës me strukturën e re.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se, procedura e deklaruar nga punëdhënësi për përfundimin e marrëdhënies së punës me A.K, për shkak të ristrukturimit dhe riorganizimit, rezultoi e provuar. Në këto kushte provohet se ankuesja nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, dhe se zgjidhja e kontratës së punës, nuk është bërë në shkelje të procedurës ligjore që duhet ndjekur për përfundimin e marrëdhënies së punës.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Shoqërisë Bankers Petroleum, për shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues.

- *Lidhur me mosmarrjen në shqyrtim të pretendimit për diskriminim të bërë nga ankuesja me e-mail-in datë 06.05.2021.*

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga palët, rezulton se me e-mail-in datë 06.05.2021 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Bankers, ankuesja në mes të tjerash ka deklaruar se: *“Bazuar në çfarë kriteri keni vendosur ndërprerjen e kontratës sime të punës? Ne jemi katër financierë në zyrë në departamentin e financës. Dua të theksoj se senior është tregues i nivelit të kualifikimit, kontributit dhe eksperiencës në këtë kompani dhe jo një pozicion. Pra për mua ky vendim ka vetëm një emër Diskriminim!”*.

Bazuar në provat e administruara rezulton se, Bankers Petroleum në cilësinë e punëdhënësit nuk ka ndërmarrë asnjë masë për shqyrtimin e pretendimit për diskriminim të paraqitur nga ankuesja brenda afateve ligjore të përcaktuara në nenin 13/1/c, të LMD-së.

Referuar deklaratës së bërë nga përfaqësuesi i Bankers në seancën dëgjimore, rezulton se Bankers Petroleum, ka qenë në dijeni të pretendimit për diskriminim të ankueses por nuk ka qenë në dijeni se çfarë shkakut pretendonte ajo.

Referuar dokumentacionit të dorëzuar, rezulton se Bankers Petroleum nuk ka shqyrtuar pretendimin për diskriminim të ankueses, por në takimin e zhvilluar mes palëve në datë 10.05.2021, ka deklaruar se: *“Me synimin për të arritur një zgjidhje sa më të pranueshme për të dy palët të situatës së shkaktuar nga pamundësia e rishikimit të ristrukturimit, si dhe e sistemimit në një pozicion të të njëjtit nivel me të njëjtën pagë për punëmarrësin, Bankers i ofron punëmarrësit një paketë kompesuese të përbërë në total nga 24 paga mujore”*.

Në nenin 5/1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”*.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 13/1/c, të LMD-së, punëdhënësi është i detyruar t’u përgjigjet efektivisht dhe në përputhje me këtë ligj ankimeve të marra për shkak të diskriminimit të kryer nga punëmarrësit e tij, brenda një muaji nga marrja e tyre.

Në këtë mënyrë, Bankers Petroleum ka shkelur nenin 13/1/c të LMD, duke dështuar që t’i përgjigjen efektivisht ankesës për diskriminim të paraqitur nga ankuesja.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Shoqëria Bankers Petroleum duhet të shqyrtonte ankesën për diskriminim të A.K, pavarësisht faktit që ankuesja nuk kishte cilësuar shkakun për të cilin pretendonte diskriminim dhe duhet ti kishte kthyer përgjigje asaj, brenda një muaji nga marrja e dijeni, për pretendimin për diskriminim.

*Sa më sipër, ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë nga ana e Bankers Petroleum, pasi i është cënuar e drejta, për të patur një zgjidhje efektive për pretendimin për diskriminim të paraqitur përpara punëdhënësit.*

## **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 1, 3/1, 5/1, neni 7/1, neni 12/1/c, 13/1/c, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

## **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të A.K, nga ana e Shoqërisë Bankers Petroleum Albania LTD, për shkak të bindjes politike dhe fetare.
2. Lidhur me mosshqyrtimin e pretendimit të ankueses për diskriminim, Komisioneri rekomandon që Shoqëria Bankers Petroleum, në të ardhmen, të parashikojë në aktet rregulluese të saj, procedura të qarta dhe të sakta mbi ankimet e punonjësve për diskriminim, si dhe të përcaktojë organin përgjegjës për trajtimin e ankesave të punonjësve.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**